



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2026

**PROCES VERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOS NDARJEN E PROCEDURËS
SË PROKURIMIT NË LOTE**

Objekti : “Blerje eskavatorë për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”

Fondi limit : 39,700,000 (tridhjetë e nentemilion e shtatëqind mijë) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 427,986 (katërqind e njëzete e shtatë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e gjashtë)
Euro, me kurs kembimi 92,76 sipas Bankes së Shqipërisë date 18.08.2026

Kodi CPV: 43262100-8 - Eskavatorë mekanikë,

Tipi i Proedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-96739-08-19-2026

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor sqarojme se:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në bazë të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar AK nuk është i detyruar ta ndajë në lote por duhet të justifikojë vendimin e vet. Kjo procedurë ndahet në lote për këto arsye:

Objekti : “Blerje eskavatorë për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”

Fondi limit : 39,700,000 (tridhjetë e nentemilion e shtatëqind mijë) Leke pa TVSH

Fondi Limit : 427,986 (katerqind e njetete e shtatemije e nenteqind e tetedhjetë e gjashtë) Euro, me kurs kembimi 92,76 sipas Bankes se Shqiperise date 18.08.2026

Kodi CPV: 43262100-8 - Eskavatorë mekanikë,

Tipi i Proedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF-96739-08-19-2026

Pas analizimit të nevojave të Bashkisë dhe karakteristikave të mallrave objekt prokurimi, vlerësohet se **ndarja në lote nuk është e nevojshme**, pasi të treja kategoritë e mjeteve përbëjnë pajisje të së njëjtës natyrë, të destinuara për realizimin e funksioneve të ngjashme dhe plotësuese në kuadër të nevojave të Bashkisë për mjete mekanike.

Megjithëse **eskavatori me zinxhir, eskavatori krahëgjatë dhe minieskavatori** kanë karakteristika dhe përdorime të ndryshme teknike, ato janë pjesë e të njëjtit grup mallrash dhe lidhen drejtpërdrejt me nevojën e Bashkisë për sigurimin e mjeteve të mekanizuara për kryerjen e punimeve të ndryshme.

Prokurimi i tyre në një procedurë të vetme mundëson **standardizimin e kërkesave teknike dhe administrative**, thjeshton procesin e furnizimit dhe administrimit të kontratës, si dhe shmang krijimin e procedurave të shumta për mallra që i përkasin të njëjtës kategori të përgjithshme.

Gjithashtu, një procedurë e vetme krijon mundësi për **administrim më të thjeshtë të kontratës**, duke përfshirë pranimin, kontrollin, dokumentacionin teknik, garancinë dhe shërbimet që lidhen me mallrat e furnizuara.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë **natyrën e përbashkët të mallrave, lidhjen funksionale ndërmjet tyre, nevojën e Bashkisë për mjete mekanike të kategorive të ndryshme, thjeshtimin e administrimit të furnizimit dhe eficiencën e procedurës**, vlerësohet e arsyeshme që **eskavatori me zinxhir, eskavatori krahëgjatë dhe minieskavatori të përfshihen në një objekt të vetëm prokurimi dhe të mos ndahen në lote.**